



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

Numri i lëndës: 2019:199589

Datë: 30.07.2020

Numri i dokumentit: 01045310

C.nr.1010/19

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Ardian Ajvazi dhe zyrtaren ligjore Ardita Tasholli, në çështjen juridike sipas padisë së paditësve M.R.1; M.R.2; SH.R; Z.R.1; F.R.1; N.R.1; H.A; XH.R; N.R.2 dhe L.R të gjithë nga Ferizaj Rr... pn, të cilët me autorizim i përfaqëson avokatja Z.Z nga Ferizaj, kundër të paditurve N.R.3; Z.R.2 dhe E.R ish nga Ferizaj, tani me adresa të panjohura, të cilët i përfaqëson përfaqësuesi i përkohshëm avokati XH.T nga Ferizaj, lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë, vlera e objektit të kontestit 8,000.00 Euro, me datë 22.07.2020 merr këtë:

A K T G J Y K I M

I. REFUZOHET në tërësi si e pa bazuar kërkesëpadia e paditësve M.R.1; M.R.2; SH.R; Z.R.1; F.R.1; N.R.1; H.A; XH.R; N.R.2 dhe L.R të gjithë nga Ferizaj Rr... pn, ushtruar kundër të paditurve N.R.3; Z.R.2 dhe E.R ish nga Ferizaj, tani me adresa të panjohura, lidhur me vërtetimin e të drejtave të bashkëpronësisë së paditësve dhe atë 1/10 e pjesës ideale në banesën e cila gjindet në Rr..., e ndërtuar në parcelën kadastrale me numër ... me sipërfaqe prej 58 m2, kati i parë, nr.28, hyrja nga pjesa veriore e objektit banesor, ZK Ferizaj.

II. DETYROHEN paditësit M.R.1; M.R.2; SH.R; Z.R.1; F.R.1; N.R.1; H.A; XH.R; N.R.2 dhe L.R të gjithë nga Ferizaj Rr... pn, që në mënyrë solidare ti paguaj shpenzimet përfaqësuesit të përkohshëm avokatit XH.T nga Ferizaj në shumën prej 374.40 Euro, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij Aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

A r s y e t i m i

Parardhësi i paditësve G.R në këtë Gjykatë ka paarshtuar padi me datë 10.08.2017, kundër të paditurës F.R.1, lidhur me vërtetimin e të drejtës së pronësisë. Për shkak të vdekjes së palëve ndërgjyqëse padia e është përmirësuar në aspektin subjektiv dhe tani palë ndërgjyqëse i kemi si në hyrje të këtij Aktgjykimi.

Paditësit në padi dhe seancat e mbajtura theksuan se paraardhësi i tyre ka qenë pronar i banesës kontestuese e cila gjindet në Ferizaj në ish Rr... hyrja E kati I, nr.4 me sipërfaqe rreth 58-

60 m2. Kjo banesë është shfrytëzuar nga paditësit dhe paraardhësi i tyre nga viti 1983, ku i është ndarë nga organizata punuese, në të cilën ka punuar G.R Ekonomia Pyjore në Ferizaj. Me instalimin e masave të dhunshme nga pushteti serb në mënyrë jo ligjore paditësin e kanë larguar nga banesa duke ia dhënë në shfrytëzim të paditurës F.R.1. Në fjalën e fundit theksoj sa i përket leximit të provave nuk ka vërejtje përpos leximit të kontratës të ofruar nga përfaqësuesi i përkohshëm e cila mban datën 22.03.1995, ngase palët kontraktuese në këtë kontratë besoj që e bëjnë kontratën të pa rëndësishme në lidhje me këtë çështje, sepse është e lidhur në vitin 1995 në kohën e masave të dhunshme, pastaj kontraktuesja figuron si shitëse Ndërmarrjan Publike “Ekonomia Pyjore e Serbisë” dhe se Ekonomia Pyjore Shtërpcë në të cilën dëshmon se shitësi në këtë kontratë është Ekonomia Pyjore e Serbisë dhe Ekonomia Pyjore e Shtërpcës dhe ligjërisht Ekonomia Pyjore e Ferizajt ka qenë organizatë e pavarur kjo të bënë për të nënkuptuar se masat e dhunshme nuk e kanë njohur legjitimitetin ekonomisë se pyjeve nga e cila paraardhësi i paditësit e ka marrur në shfrytëzim banesën objekt kontesti dhe ligjërisht nënshkruesi i kësaj kontrate është jo legal kjo për shkak të masave të dhunshme të vitetve të 90-ta. Andaj mendoj se çdo veprim juridik, dhe çdo vendim administrativ apo çfarëdo që të jetë në lidhje me këtë çështje para viteve të 90-ta është i ligjshëm ndërsa vendimet e masave të dhunshme konsideroj se janë të pa vlefshme – të pa ligjshme. Konsideroj se në lidhje me këtë çështje gjykatës i kemi ofruar prova të mjaftueshme të nënshkruara nga organet kompetente të kohës në të cilën dëshmohet se padia e paditësve është e bazuar dhe e ligjshme, ndërsa sa i përket precizimit të padisë në pikëpamje subjektive duke qenë se fillimisht paditës në këtë çështje ka qenë tani i ndjeri G.R, dhe me vdekjen e tij e drejta ligjore për të kërkuar vërtetimin të drejtës së pronësisë të kësaj banese u takon pasardhësve të tij. Kërkoj nga gjykata që pasardhësve të G.R t’ua njohë të drejtën e pronësisë me pjesë ideale me nga 1/10 në banesën e cila gjendet në rrugën ..., e ndërtuar ne ng.nr.... me sip.58 m2, kati i parë ZK Ferizaj.

Përfaqësuesi i përkohshëm në përgjigje në padi ka kundërshtuar në tërësi kërkesëpadinë e paditësve, duke propozuar që e njëjta të refuzohet në tërësi si e pa bazuar. Në fjalën e fundit i propozoj Gjykatës që të nxjerrë vendim të bazuar në dispozitat ligjore, po ashtu kërkoj shpenzimet e procedurës.

Gjykata me qëllim të vërtetimit të drejtë të gjendjes së fakteve të çështjes, për aq sa palët ndërgjyqëse përmbushin detyrimin e tyre për t’i parashtruar ato, në kuptim të nenit 7.1 të LPK-së, ka administruar: Vendimi i datës 19.11.1983, përmes së cilit vërtetohet fakti se G.R i është ndarë banesa e solidaritetit në shfrytëzim të përhershëm; Vendimi i datës 29.06.1985, përmes së cilit paraardhësit të paditësve i është ndarë banesa e solidaritetit për shfrytëzim të përhershëm; Aktvendimin e datës 30.10.1986, përmes së cilit vërtetohen këto fakte Kuvendi i Komunës së Ferizajt, duke vendosur sipas kërkesës së UP të Pylltarisë “Sharr” në Prishtinë, OTHPB Ekonomia e Pyjeve në Ferizaj, për largimin e G.R nga banesa kontestuese, përmes këtij vendimi është refuzuar kjo kërkesë; Vendimi i datës 18.03.1987, përmes së cilit vërtetohet fakti se paraardhësit të paditësve i është ndarë banesa e solidaritetit; Kontrata e datës 22.03.1995, përmes së cilës vërtetohet fakti se F.R.1 në cilësinë e blerëses dhe Ndërmarrjes Publike Ekonomia Pyjore e Serbisë dhe Ekonomia Pyjore Shtërpcë në cilësinë e shitëses kanë hyrë në marrëdhënia kontratuale për shitblerjen e banesës kontestuese; Cetifikata e vdekjes e datës 30.08.2019, përmes së cilës vërtetohet fakti i vdekjes së G.R me datë 20.10.2016; Dëshmi vdekjeje e datës

30.08.2019, përmes së cilës vërtetohet legjitimiteti aktiv i paditësve: M.R.1 djali, M.R.2 djali, SH.R djali, Z.A vajza, F.R.1 vajza, N.R.1 djali, H.A vajza, XH.R vajza, N.R.2-A... vajza dhe L.R; Certifikata e vdekjes e datës 20.11.2019, përmes së cilës vërtetohet fakti vendimtar ai i vdekjes së F.R.1 me datë 02.07.2008, pronare e banesës kontestuese; Parashtrësia për kërkimin e shtetave, përmes së cilës shihet se Gjykata fillimisht i është drejtuar Zyrës së Gjendjes Civile në Ferizaj për t'na i siguruar pas ardhësit e të ndjerës F.R.1, mirëpo sipas përgjigjes së tyre nuk kanë mundur të bëjnë një gjë të tillë për shkak të mungesës së të dhënave të tjera; Njoftimi i datës 13.12.2019, përmes së cilit Komuna e Ferizajt, zyrtari i Gjendjes Civile nuk ka mundur të vërtetojë faktin se të paditurit janë trashëgimtar të F.R.1. Në parashtrësën për kërkimin e shtetasëve në rubrikën e parë shënon emri dhe mbiemri i N.R.4, me numër personal ...6, emir i babait Isa Rexhepi, ndërsa i nënës F.R.2. Gjykata vlerëson se as për të paditurin N.R.4 i nuk është vërtetuar legjitimiteti i tij pasiv, për arsye se i njëjti është i lindur me datë 01.10.1957, ndërsa F.R.2 është e lindur me datë 18.11.1951, çka do të thotë se F... është më e madhe se sa N... 6 vite dhe nuk ka mundur të jetë nëna e tij; Ekspertiza gjeodezike qershor 2020, përmes së cilës vërtetohet fakti vendimtar se F.R.1 është e regjistruar në regjistrat kadastral si pronare e banesës të ndërtuar në objektin kolektiv me Nr...-... ZK Ferizaj e cila gjindet në Rr.... me sipërfaqe prej 58 m². Banesa gjindet në pjesën juglindore të qytetit të Ferizajt, shtrihet përgjatë Rr..., në katin e parë nr.28 dhe hyrja është nga pjesa veriore e objektit; Fatura e tatimit në pronë e datës 31.01.2020, përmes së cilës vërtetohet fakti se F.R.1 është nga Komuna e Ferizajt është ngarkuar me tatimin në pronë, me numër të tatimpaguesit ..., e që shuma e tërësishme e tatimit në pronë është 169.90 Euro.

Gjykata gjatë vlerësimit të pohimeve të të autorizuarit të paditësit dhe të paditurit dhe provave marrura dhe të administruara në kuptim të nenit 8 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike, me kujdes dhe me ndërgjegje ka çmuar çdo provë veç e veç dhe të gjitha ato së bashku, ka gjetur se kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar në tërësi.

Gjykata konstaton se në certifikatën e pronësisë emri i paditëses është F..., ndërsa në certifikatën e vdekjes F..., ndërsa fakti vendimtar se kemi të bëjmë me të njëjtin person vërtetohet përmes numrit personal që është i njëjtë si në certifikatën e pronësisë ashtu edhe në certifikatën e vdekjes ... lëshuar nga MPB.

Provat e administruara më lartë, përmveq ekspertizës gjeodezike, certifikatës së pronësisë, certifikatës së vdekjes së datës 20.11.2019 dhe njoftimit nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile në Ferizaj, nuk patën ndonjë relevancë që në këtë çështje të vendoset ndryshe, për arsye se kemi mungesë të legjitimitetit të të paditurve, pra përmes tyre nuk mund të vërtetohet e drejta e pronësisë së paditësve në banesën kontestuese.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret kemi mungesë të legjitimitetit pasiv të të paditurve, për arsye se të njëjtit nuk janë pronar të banesës kontestuese, në të cilën paditësit kërkojnë vërtetimin e të drejtës së pronësisë, ky fakt vendimtar në këtë çështje juridike kontestimore është vërtetuar nga certifikata e pronësisë e datës 30.01.2020 dhe ekspertizës gjeodezike, në të cilën figuron pronar F.R.1, ndërsa të paditur në këtë çështje janë N.R.3; Z.R.2

dhe E.R ish nga Ferizaj, tani me adresa të panjohura. Sa i përket legjitimitetit pasiv të palës së paditur Gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare për arsye se është e karakterit material-juridik dhe në rastin konkret pronari juridik i banesës objekt kontesti dhe të paditurit me asnjë provë nuk është vërtetuar se kanë qenë pjesëmarrëse të raportit juridik. Pala ndaj të cilit drejtohet kërkesa duhet të legjitimohet në aspektin pasiv, për arsye se vetëm përmes saj mund të realizohet kërkesa e paditësit, nëse përmbushen kushtet ligjore për fitimin e të drejtës së pronësisë. Gjykata në rastin konkret konstaton se vërtetë të paditurve i mungon legjitimiteti i plotë real pasiv për të qenë palë në kontestin lëndor. Kjo për arsye se legjitimiteti real është marrëdhënie e palëve të sajura në bazë të ndonjë raportit juridik-civil, nga e cila rrjedhin të drejtat subjektive dhe me rastin e cënimit të tyre titullari i të drejtës subjektive të cënuar ka të drejtë të kërkon mbrojtje ligjore. Andaj, për këtë arsye dhe duke pasur parasysh faktin se mungesa e legjitimitetit të plotë është e karakterit material-juridik, rezulton se padia dhe kërkesëpadia e paditësve në raport me të paditurit është e pa bazuar. Me asnjë provë nuk është vërtetuar legjitimiteti pasiv i të paditurve, i cili kishte mundur të vërtetohej sikur paditësit të siguronin dëshminë e vdekjes dhe aktvdekjen për të paditurën fillestare F.R.1. Paditësit legjitimitetin aktiv të tyre pas vdekjes së paraardhësit të tyre G.R e kanë vërtetuar përmes dëshmisë së vdekjes, në të njëjtën mënyrë është dashur të vërtetohet edhe legjitimiteti pasiv i të paditurve pas vdekjes së të paditurës fillestare.

Gjykata përmes certifikatës së vdekjes të datës 20.11.2019 ka vërtetuar fakti me rëndësi se F.R.2 ka vdekur me datë 02.07.2008, e cila është edhe pronare e banesës kontestuese, ndërsa paditësit me prova kanë dështuar të provojën faktin me rëndësi se tani të paditurit N.R.3; Z.R.2 dhe E.R ish nga Ferizaj, tani me adresa të panjohura janë pasardhës të saj që më pastaj të mund të legjitimohen në aspektin pasiv. Gjykata konstaton se padia e paditësit G.R paraardhësi i paditësve është ushtruar me datë 10.08.2013, ndërsa duke marrë parasysh kohën e vdekjes së të paditurës F..., shihet se e njëjta është parashtruar pas 5 viteve pasi ka vdekur kjo e fundit. Gjykata përmes parashtrësës së datës 11.12.2019 sipas detyrës zyrtare ka kërkuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Ferizaj që të paditurit N.R.3; Z.R.2 dhe E.R ish nga Ferizaj, tani me adresa të panjohura a janë pasardhës të F.R.1. Zyra e Gjendjes Civile përmes njoftimit të datës 13.12.2019 nuk kanë mundur të vërtetojnë faktin se të paditurit janë pasardhës të F.R.2

Faktet vendimtare në këtë çështje kontestimore janë vërtetuar përmes ekspertizës gjeodezike, certifikatës së pronësisë, certifikatës së vdekjes së datës 20.11.2019 dhe njoftimit nga ana e Zyrës së Gjendjes Civile në Ferizaj.

Si përfundim kërkesëpadia e paditësve është e pa bazuar për shkak të mungesës së legjitimitetit të të paditurve, pra përmes tyre paditësit nuk mund ta realizon të drejtën e pronësisë, për arsye se as të paditurit këtë të drejtë nuk e ka të regjistruar në regjistrat kadastral, përkatësisht nuk është vërtetuar me prova se të njëjtit janë trashëgimtar të të ndjerës F.R.2

Baza ligjore: Neni 20 i LMTHJP; Kushtetuta e Republikës së Kosovës nenet: 22; 46 dhe 121 dhe Protokollin shtesë i Konventës për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore neni 1.

Gjykata sa i përket shpenzimeve të procedurës është bazuar në nenin 450 të LPK-së dhe Tarifën e Odës së Avokatëve dhe atë për dy séance shumë prej 270.40 Euro dhe për përgjigje në padi shumë prej 104.00 Euro.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi, bazuar në nenin 143 të LPK-së.

GJYKATA THEMELORE NE FERIZAJ
C.nr.1010/19, me datë 22.07.2020

Gjyqtari,
Ardian Ajvazi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij Aktgjykimi është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh, nga dita e pranimit të tij në Gjykatën e Apelit të Kosovës në Prishtinë, e të dorëzohet nëpërmjet kësaj Gjykate.